


01-2259



Në bazë të nenit 21, 22 dhe 44 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 20/21 qershor 2016), nenit 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 18/03 korrik 2012), nenit 49, 50 dhe 51 të Ligjit Nr. 2004/15 të dt. 27.05.2004 nenit 17 pika “d” e Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 dt. 20.02.2008, nenit 15 pika “d” e Statutit të Komunës së Prishtinës Nr. 110-391 dt. 25.02.2010, dispozitave të nenit 14 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit, dhe duke vendosur sipas kërkesës 05 Nr. 391/02-274542/22 dt. 23.12.2022, të pronarëve Drita Neziri, Mehmet Çoçaj, Ibish Çoçaj, Gani Çoçaj, nga Prishtina, me investitor “Trio Construction” sh.p.k. rr. “Ali Vitija”, p.n., Prishtinë, për lëshimin e certifikatës së përdorimit për ndërtesën shumëbanesore me afarizëm, përkatësisht ndërtesa “blloku A, objekti 1”, me etazhitet B+P+8, në kuadër të bllokut urban “C6”, të Planit Rregullues “Kalabria” në Prishtinë, Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, në procedurë administrative, me datën 09.10.2023 lëshon këtë:

V E N D I M
C E R T I F I K A T Ë E P Ë R D O R I M I T

I. I LËSHOHET Certifikata e përdorimit pronarëve Drita Neziri, Mehmet Çoçaj, Ibish Çoçaj, Gani Çoçaj, nga Prishtina, me investitor “Trio Construction” sh.p.k. rr. “Ali Vitija”, p.n., Prishtinë, sipas kërkesës 05 Nr. 391/02-274542/22 dt. 23.12.2022, për përdorimin e ndërtesës shumëbanesore me afarizëm, përkatësisht ndërtesa “blloku A, objekti 1”, me etazhitet B+P+8, e ndërtuar në kuadër të bllokut urban “C6”, të Planit Rregullues “Kalabria”, Prishtinë, konkretisht në parcelën kadastrale nr. 01852-1, ZK Prishtinë, sipas Vendimit 05 Nr. 351-10949 dt. 01.06.2012 për lejimin e ndërtimit të ndërtesës.

II. Ndërtesa, mund të përdoret, sipas destinimit të përcaktuar në pikën I. të Vendimit të Lejes Ndërtimore Vendimit 05 Nr. 351-10949 dt. 01.06.2012, dokumentacionit ndërtimor dhe Raportit të Komisionit profesional të pranimit teknik të ndërtesës.

III. Ndërtesa mund të përdoret nga dita e marrjes në dorëzim të kësaj Certificate.

IV. Kjo Certificate shërben për regjistrimin e ndërtesës në regjistrin kadastral të përshkruar në pikën I. të këtij vendimi.

A r s y e t i m

Pronarët Drita Neziri, Mehmet Çoçaj, Ibish Çoçaj, Gani Çoçaj, nga Prishtina, me investitor “Trio Construction” sh.p.k. rr. “Ali Vitija”, p.n., Prishtinë, më kërkesën me 05 Nr. 391/02-274542/22 dt. 23.12.2022, i janë drejtuar kësaj Drejtorie, për lëshimin e certifikatës së përdorimit për përdorimin e ndërtesës shumëbanesore me afarizëm, përkatësisht ndërtesa “blloku A, objekti 1”, me etazhitet B+P+8, në lokacionin e përshkruar si në pikën I. të dispozitivit të kësaj certificate.

Me kërkesë, investitori ka prezantuar:

- Aktvendimi nr. 05 Nr. 351-10949 dt. 01.06.2012, për lejimin e ndërtimit të ndërtesës objekt shumëbanesore me afarizëm, me etazhitet B+P+8, të pronarëve Neziri, Mehmet Çoçaj, Ibish Çoçaj, Gani Çoçaj, nga Prishtina, me investitor “Trio Construction” sh.p.k. rr. “Ali Vitija”,

p.n., Prishtinë, në kuadër të bllokut urban "C6", të Planit Rregullues "Kalabria", Prishtinë, konkretisht në parcelën kadastrale nr. 01852-1, ZK Prishtinë.

- Aktvendimi nr. 05 Nr. 351-10949 dt. 12.04.2012, mbi kompensimin për rregullimin e tokës ndërtimore të pronarëve Neziri, Mehmet Çoçaj, Ibish Çoçaj, Gani Çoçaj, nga Prishtina, me investitor "Trio Construction" sh.p.k. rr. "Ali Vitija", p.n., Prishtinë, në kuadër të bllokut urban "A", të Planit Rregullues "Kalabria", Prishtinë, konkretisht në parcelën kadastrale nr. 01852-1, ZK Prishtinë.
- Procesverbalin mbi kontrollimin teknik të ndërtesës nga komisioni profesional i emëruar nga kjo Drejtoria sipas Vendimit me nr. 05 Nr. 391/02-200240/21 dt. 02.12.2021.
- Incizimin gjeodezik të objektit, dhe rregullimit të jashtëm-gjendjen e realizuar, me vijën rregullative dhe vijën ndërtimore e vendosur në sistemin koordinativ sipas Kosovaref 01,
- Atestet e materialeve dhe rezultatet e testimeve,
- Fotografi gjatë procesit të ndërtimit,
- Çertifikata e pronës dhe kopja e planit

Drejtorja e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, pas shqyrtimit të kërkesës, provave të lëndës, konkretisht Raportit të Komisionit profesional të pranimit teknik të ndërtesës dhe të dokumentacionit të dorëzuar nga ana e investitorit, ka konstatuar:

Ndërtesa shumëbanesore me afarizëm, me etazhitet B+P+8 është ndërtuar në pajtim me Vendimet e cekura më lartë dhe dokumentacionin tjetër teknik dhe se i njëjti i përmush normativat dhe standardet, aplikimi i të cilave është i domosdoshëm me rastin e ndërtimit të ndërtesave të tilla, kështu që ndërtesa në fjalë mund të përdoret/shfrytëzohet, gjegjësisht të lëshohet certifikata e përdorimit.

Bazuar në konstatimet e më sipërme u vendos si në dispozitiv të kësaj Certifikate.

Udhëzimi juridik: Pala e pakënaqur me këtë Certifikatë, me ankesë mund ti drejtohet kësaj drejtorie brenda afatit prej 30 ditësh, duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të kësaj Certifikate. Bazuar në vlerësimin nga kjo drejtori, ankesa do të shqyrtohet apo do të përcillet te organi epror – MMPH-ja.

I dorëzohet: Kërkuesit/Investitorit, Drejtorisë së Kadastrit, Drejtorisë së Inspeksionit, kësaj drejtorie, Qendrës për shërbim me qytetarë dhe në dosje të lëndës.

**DREJTORIA E URBANIZMIT E KOMUNËS SË PRISHTINËS,
05 NR. 391/02-274542/22 DT. 09.10.2023**

Zyrtari:

Bahtije Vllasaliu



Udhëheqëse e sektorit:

Nazife Krasniqi

